



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:165384
Datë: 21.11.2024
Numri i dokumentit: 06489045

P.nr.643/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e praktikantit gjygjësor Dardan Tolaj, në çështjen penale kundër të pandehurit, Besmir Kastrati nga P.për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.704/2023 të dt.03.08.2023, pas mbajtjes së seancës shqyrtimit fillestar ë mbajtur me datë 01.11.2024, në praninë e Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit Besmir Kastrati dhe mbrojtësit të tij av.Valdrin Bajraktari, me datë 04.11.2024, mur dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 21.11.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

BESMIR KASTRATI, i lindur me datë, në P, nga i ati I, e ëma A, e vajzërisë B, me vendbanim në f.sh D në P si dhe në N, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, beqar, i gjendjes së dobët financiare, i identifikuar me numër personalnumër telefoni dhe, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës dhe Norvegjisë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, Me parë e gjerë me datë, rreth orës 10:00 në fshatin D. K. Pejë, pikërisht në shtëpinë e tij, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), pa autorizim dhe leje përkatëse ka mbajtur në pronësi dhe kontroll: **Një (1) Pushkë automatike “Kallashnikov” prodhim kinez, cal. 7.62x25 mm me numër serik 3105182, një (1) karikator i zbrazët i së njëjtës armë**, në atë mënyrë që ditën kritike zyrtaret policor duke vepruar sipas urdhrit UGJK.nr. 56/2023 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë -Gjyqtari të Procedurës Paraprake, kanë shkuar në shtëpinë e të pandehurit dhe pasi që i njëjti njoftohet për

arsyen e prezencës së policisë aty, i pandehuri pranon se ka në posedim armën e lartcekur së bashku me karikator, ku te njëjtat më pas i janë sekuestruar nga policia.

- me çka ka kryer vepër penale „ Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 43, 69, 70, nenit 366 par.1 nën të KPRK-së , dhe nenit 364, 365, 452 par.1 të KPRK-së, gjykata të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I.** Shumën në lartësi prej **1000 € (njëmijë euro)** të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj brenda afatit prej **30 (tridhjetë) ditëve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguajë gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ku një ditë me burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës.
- III.** I pandehuri obligohet të paguaj e shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej **50 € (pesëdhjetë euro)**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV.** I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- V** **KONFISKOHET** arma e tipit pushkë automatike prodhim kinez 7.62x25 mm me nr. serik 3105182, një karikator të së njëjtës armë, dhe **Urdhërohet** shkatërrimi i tyre, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën, PP/II.nr.704/2023 të dt.03.08.2023, kundër të pandehurit Besmir Kastrati nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „ Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 01.11.2024 në praninë e Prokurori i Shtetit, Ermal Demhasaj, të pandehurit Besmir Kastrati, dhe mbrojtësi i tij av. Valdrin Bajraktari sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata e bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke i udhëzuar për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, konform dispozitës së nenit 241 par.4 të KPPRK-së.

I pandehuri Besmir Kastrati, deklaroi se e pranon në mënyrë vullnetare fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e ka bërë pa asnjë presion dhe pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi është bërë në mënyrë vullnetare, me vetëdije të plotë, duke e kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe meqenëse ka mbështetje në prova të cilat gjendjen në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, meqenëse pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë me vullnet të plote dhe pa presion.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e tij është bërë vullnetarisht konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit i dt. 13.04.2023, raporti i oficerit A. S. i dt. 13.04.2023, raport informues i dt. 13.04.2023, deklarata e të pandehurit Besmir Kastrati e dhënë në Stacionin Policor në Pejë dhe ne këtë Prokurori, lista e armëve të konfiskuara dt. 13.04.2023, lisat e dëshmimeve, fotografi nga vendi i ngjarjes, urdhër për bastisje kontroll, si dhe dokumentacioni tjetër shkresave të lëndës. Prokurori i shtetit lidhur me caktimin e dënimit i propozoi gjykatës, që në kontekst të rrethanave lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese dënimet eventuale të mëparshme.

Prokurori i shtetit lidhur me rrethanat ka deklaruar që në kontest të rrethanave lehtësuese të merret parasysh se i njëjti e ka bërë pranimin e fajësisë, kurse si rrethanë rënduese dënimet eventuale të mëparshme të të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit i ka propozuar gjykatës që si rrethane lehtësuese të merr pranimin e fajësisë dhe se i njëjti është hera e parë që bie ndesh me ligjin, po ashtu i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të shqiptojë një dënim sa më të butë.

I pandehuri, është pajtuar me fjalët e mbrojtësit të tij.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Besmir Kastrati qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjykata gjatë procedurës penale nuk gjeti rrethana të cilat do të zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata, për vendimin mbi dënim ka vendosur pasi që i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, ka vlerësuar faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë, është penduar për atë çfarë ka shkaktuar, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata për të njëjtin nuk gjeti asgjë.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit. Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin dhe asgjësimin e pasurisë të sekuestruar sipas procesverbalit mbi sekuestrimin e provave apo pasurisë me numër të rastit në polici 2023-DA-499 dt.13.04.2023 - Pejë dhe numrit të dosjes së forenzikës NJTKR-Pejë 210/2023, mori konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën

paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM/Divizioni Penal
P.nr.643/2023, me datë 21.11.2024

Praktikanti Gjqësor

Gjyqtare e vetme gjykuese

Dardan Tolaj

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.